



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА
ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT
STATE AUDIT OFFICE

Abstrakti i raportit përfundimtar i revizionit

Subjektet kyçe të përfshira në raportin e revizionit:

Ndërmarrja Publike Komunale Komunalec Sveti Nikollë

Lënda e revizionit:

Revizioni i raporteve financiare bashkë me revizionin e pajtueshmërisë për vitin 2021.

Qëllimi i revizionit:


Të fitohet bindje e arsyeshme nëse raportet financiare të marra janë liruar nga paraqitjet e gabuara materialisht, ndërsa transaksionet dhe aktivitetet e reflektuara janë në pajtim me rregullativën ligjore.

Gjendjet kyçe të konstatuara:

- sistemi i furnizimit me ujë regjistron 38% humbje të ujit;
- për shërbimet e kryera janë lidhur kontrata vetëm me 57% nga shfrytëzuesit e shërbimeve të NPK;
- vlerësimi i pozicioneve të bilancit nuk është në pajtim me SNK
- në librat afariste janë evidentuar objekte dhe toka për të cilët nuk janë siguruar dokumente për pronësi.

Mendimi i dhënë/konkluzioni*:

Shprehëm mendim të pavolitshëm për vërtetësinë dhe objektivitetin e raporteve financiare për vitin 2021 dhe për pajtueshmërinë me rregullativën ligjore, udhëzimet dhe politikat e vendosura.



Rekomandimet kyçe:

- të vazhdojnë aktivitetet për lidhjen e kontratave me të cilët do të rregullohen detyrimet dhe të drejtat e ndërsjella me shfrytëzuesit e shërbimeve;
- menjanimi i faktorëve të cilët kontribuojnë për humbjen e ujit.

Dobësitë kyçe të sistemit:

/

Vërejtjet e marra të draft-raportit:

Nga personi i autorizuar i NPK Komunalec Sveti Nikollë janë marrë vërejtje numër 0306-120 nga 02.03.2023 për Draft-Raportin e revizorit të autorizuar shtetëror

Përgjigjet e vërejtjeve të marra:

Vërejtjet janë shqyrtuar me çka një vërejtje pjesërisht është pranuar, tre nuk janë pranuar, ndërsa të tjerat paraqesin njoftim dhe arsyetim për gjendjet e konstatuara dhe masat e ndërmarra ose masat të cilat do të ndërmerren në të ardhmen.

* pozitive, me rezervë të pavolitshëm të përmbajtur